

E nderuara dhe e respektuara familje e Akademik Salih Gashit,  
I nderuar kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,  
Të nderuar akademikë,  
Të nderuar profesorë,  
Të nderuar të pranishëm,

Me pikëllim shumë të thellë e morëm lajmin se më 21 prill 2025 ndërroi jetë akademik Salih Gashi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i cili për 12 vite ishte pjesë e Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Akademik Salih T. Gashi u lind më 1944 në fshatin Baran të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pejë. Në vitin 1962/63 u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, Departamenti i Kimisë, në Universitetin e Prishtinës dhe pas vitit të dytë vazhdoi studimet në Universitetin e Beogradit, ku u diplomua në vitin 1966. Pas përfundimit të studimeve punoi në Kombinatin Trepça, Minierat dhe Flotacioni, në Kishnicë dhe Novo Bërdë (Artanë), si udhëheqës i laboratorit të kimisë. Në vitin 1969/70 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Fakultetin Teknologjik të Universitetit të Zagrebit ku magjistroi në vitin 1971 me temën "Studimi i fraksionimit të polistirenit" dhe mori titullin magjistër i shkencave të kimisë. Në vitin 1972 u zgjodh asistent i kimisë fizike në Departamentin e Kimisë në FSHMN të Universitetit të Prishtinës, ndërsa një vit më vonë, u zgjodh ligjërues i po asaj lënde. Në vitin 1978 mbrojti tezën e doktoratës me titull "Hulumtimi i strukturës poroze të membranave të osmozës së kundërt dhe përdorimi i tyre për pastrimin e ujërave të ndotura" në Universitetin e Zagrebit. Po këtë vit u zgjodh docent për lëndën Kimia fizike në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. Gjatë kësaj periudhe ka qenë në specializim në Universitetin e Bërnos dhe në Institutin "Hidroprojekt", Bërno, (ish Çekoslllovakia). Në vitin 1979/80 ka vazhduar studimet e postdoktoratës në Departamentin e Kimisë të Universitetit të Aberdeenit (Skoci, Britani e Madhe). Akademik Salih Gashi përgatiti për herë të parë membranat heterogjene të osmozës së kundërt në Universitetin e Prishtinës. Falë këtyre rezultateve të shkëlqyeshme në punën hulumtuese në vitin 1980 ka marrë mirënjohje për punën e suksesshme në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. Në vitin 1984 është zgjedhur profesor inordinar për lëndën Kimia Fizike në këtë fakultet. Në vitin 1985 është ftuar profesor vizitor në Universitetin e Jenës dhe në Institutin e makromolekulave të Akademisë së Shkencave të Berlinit. Gjatë qëndrimit të tij atje i ka mbajtur dy ligjërata nga lëmi i osmozës së kundërt (apo osmozës reverse). Në vitin 1988 u zgjodh anëtar i "European Society of Membrane Science and Technology" "Shoqatës Europiane të Shkencave të Membranave dhe Teknologjisë". Në vitin 1993 senati i Universitetit të Prishtinës e zgjodhi profesor ordinar të kimisë fizike në Departamentin e Kimisë në FSHMN. Po këtë vit u zgjodh kryeredaktor për botimin e teksteve të shkencave të natyrës në UP. Si shumë studentë të Departamentit të Kimisë, edhe unë kam pasur fatin dhe privilegjin që akademik Salih Gashin ta kem mësimdhënës e pastaj kam mundur të bashkëpunoj me të për një çerek shekulli. Ai ka dhënë

një kontribut të shumë të rëndësishëm në zhvillimin e Katedrës së Kimisë fizike në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë përherë në krye të detyrës dhe çdo herë i gatshëm t'i përkrahë, të udhëheqë dhe të motivojë kuadrin më të ri. Kolegët dhe studentët që kishin mundësinë ta njihnin nga afër, e kanë konsideruar atë si njeri parimor dhe shumë i qëndrueshëm i cili nuk ka hezituar ta bëjë publik mendimin e tij për çështje akademike, shkencore dhe kombëtare.

Ai gjithashtu e ka motivuar kuadrin e ri të merr pjesë aktive në punën kërkimore shkencore dhe ka nxitur pjesëmarrjen në forumet kombëtare dhe ndërkombëtare të shkencës. Bashkëpunimin me Shqipërinë e ka mbajtur aktivisht qysh prej viteve të 70 të shekullit XX kur ishte plejada e parë e profesorëve të Kimisë të Universitetit të Tiranës e deri në kohën e fundit duke qenë anëtar i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut. Akademik Salih Gashi ka udhëhequr një numër të konsiderueshëm të kandidatëve në studimet e magjistraturës si dhe 3 kandidatë në studimet e doktoratës.

Më 2012 mori mirënjohje nga FSHMN me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Në vitin 2012 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Nga viti 2013 ishte anëtar i “Grupit punues të ALLEA’s për Edukimin në Shkencë”. Ka qenë anëtar korrespondent i “Euro Science Open Forum” “Forumit të hapur të shkencës europiane”. Në vitin 2017 është zgjedhë Kryeredaktor i Revistës Shkencore të ASHAK “Research-Kërkime.” ndërsa në vitin 2020 është rizgjedhë në detyrë të njëjtë. Gjatë punës së tij si kryeredaktor i revistës ka qenë përherë aktiv në mbikëqyrje të procesit të vlerësimit të dorëshkrimit të punimeve si dhe në përgatitjen e punimeve për botim.

Bibliografia e akademik Salihut është shumë e pasur. Është autor dhe bashkautor i 60 punimeve shkencore, një pjesë e konsiderueshme të cilave janë botuar në revistat shkencore të kimisë që gjenden në platformat kryesore të revistave. Ai është edhe pjesëmarrës në mëse 80 tubime shkencore, shumica e tyre kanë qenë prezantime me gojë në konferencat e ndryshme jashtë vendit.

Ka udhëhequr ose ka marr pjesë si anëtar ekipi në 12 projekte shkencore dhe është autor ose bashkautor i tri teksteve universitare. Në ASHAK i ka botuar 2 libra shkencor: “Osmoza e kundërt” është botuar në vitin 2017 dhe “Proceset konvencionale membranore dhe të integruara (Parimet dhe zbatimi)” u botua në vitin 2023.

Ka qenë bashkë autor edhe i dy kapitujve të librave që janë botuar në vitin 1985 dhe 1987 nga botues ndërkombëtar.

Akademik Salih Gashi ka dhënë një kontribut të madh në udhëheqjen e Redaksisë së Mjedisit për pjesën e Kosovës në kuadër të projektit të Enciklopedisë shqiptare. Ai arriti që me kohë të finalizoj listën e zërave të përbashkët me Redaksinë homologe në Shqipëri falë komunikimit të vazhdueshëm që e kishin të dy redaksitë.

Krahas veprimtarisë akademike dhe shkencore akademik Salih Gashi ka qenë përherë pjesëmarrës në të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur nëpër dekada në Universitetin e Prishtinës, i cili ishte bastion i kundërshtimit të shtypjes së regjimit komunist dhe okupues serb, i cili e ndaloi edhe punën e Universitetit në hapësirat e tij publike. Ka marr pjesë aktive në protestat e organizuara dhe

ka dhënë kontribut në organizimin e mësimit në shtëpitë private gjatë viteve 90.

Në vitet 2000-2002 u zgjodh kryetar i parë i Kuvendit Komunal të Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe akademik Salih Gashi ka dhënë kontribut shumë të madh për rindërtimin e Kryeqytetit si dhe i ka vënë në funksion institucionet dhe mekanizmat e nevojshëm në shërbimin publik.

Me ndarjen nga jeta, familja e humbi prindin, gjyshin shembullor, ne e humbëm një anëtar të Akademisë me vlera shumë të veçanta si në aspektin e kontributit shkencor dhe në atë akademik e kombëtar por njëherit si familja e tij e respektuar e edhe ne si institucion jemi me shumë fat se do të kemi në shfrytëzim trashëgiminë e tij shkencore shumë të begatë si dhe do të jemi përherë krenar me veprën e tij.

Lavdi jetës dhe veprës së Akademik Salih Gashit!